

BULETINI CENS 2020

NR. 3 | JANAR - MARS 2019 |



Buletini Informues Cens 2020 shërben si pasqyrë e aktiviteteve kryesore që INSTAT ka ndërmarrë dhe do të ndërmarrë deri në përfundim të këtij projekti. Ai do të shpërndahet me një frekuencë tremujore. Pas publikimit të numrit të dytë në Dhjetor 2018, në numrin e tretë të buletinit do të paraqiten aktivitetet e zhvilluara gjatë periudhës Janar-Mars 2019 dhe çfarë pritet të ndodhë gjatë në muajit në vijim.

CENSI I POPULLSISË DHE BANESAVE 2020

Instituti i Statistikave të Shqipërisë (INSTAT) ka planifikuar të kryejë Cens-in e ardhshëm të Popullsisë dhe Banesave në vitin 2020. Cens-i i Popullsisë dhe Banesave 2020 do të ndjekë metodën e numërimit të drejtpërdrejtë universale bazuar në operacionet në terren me përpilimin e pyetësorëve nga anketuesit, duke përdorur metoda të reja për mbledhjen e të dhënave.

Kontaktet:

Delina Ibrahimaj, Drejtore e Përgjithshme e INSTAT
DIbrahimaj@instat.gov.al

Alban Çela, Drejtues i Njesisë IPA
ACela@instat.gov.al

Gladiola Baja, Përgjegjëse e Sektorit të Koordinimit të Projekteve
GBaja@instat.gov.al

Klajd Shuka, Përgjegjës për Zbatimin Operacional të Projektit
KShuka@instat.gov.al

Helda Mitre, Përgjegjës për Zbatimin Teknik të Projektit
HMitre@instat.gov.al

Altin Xhikneli, Përgjegjës për Komunikimin
AXhikneli@instat.gov.al

Instituti i Statistikave
Rr. Vllazën Huta,
Ndërtesa 35, Hyrja 1
Tiranë, Kodi Postar 1017

Cens2020@instat.gov.al
www.instat.gov.al
Tel: +355 4 2222 411
Faks: +355 4 2222 411

PËRMBAJTJA

Aktivitetet e CENS 2020,
Janar-Shkurt-Mars 2019

- Takimi i parë për projektin “Mbështetje për Zbatimin aktiviteteve të Cens 2020”
- Mision nga BE
- Mision ad-hoc për planin e aktiviteteve për Pilotin e Censit
- Mision financiar nga INSEE për Censin 2020
- Takim teknik mbi Draft-Pyetësorin e Censit 2020
- Finalizimi i draft-pyetësorit të Censit 2020

- Rekrutohet stafi i nevojshëm për Censin 2020
- Procedurat e prokurimit për Censin 2020
- Nis procesi për përditësimin e hartave
- INSTAT përgatit draft-aplikacionin për mbledhjen e të dhënave në terren
- Shpallet hapja e konkursit për logon Cens 2020
- Këshilli i Ministrave propozon Projektligjin e ri të Censit 2020
- Ecuria e planit të aktiviteteve

Takimi i parë në kuadër të projektit “Mbështetje për Zbatimin e aktiviteteve të Censit të Popullsisë dhe Banesave 2020, në Shqipëri”

Në ambientet e INSTAT u zhvillua më 26 Mars 2019 takimi i parë në kuadër të projektit “Mbështetje për Zbatimin e aktiviteteve të Censit të Popullsisë dhe Banesave 2020, në Shqipëri”, me pjesëmarrjen e Delegacionit Evropian, përfaqësuesve të EUROSTAT, donatorëve, si dhe gjithë aktorëve të përfshirë në këtë proces. Ky takim kishte për qëllim prezantimin e punës përgatitore për realizimin e Censit 2020, planit të aktiviteteve për vitin 2019, si dhe sigurimin e angazhimit të të gjithë partnerëve në këtë aktivitet të rëndësishëm.



Mision nga BE në kuadër të Censit të Popullsisë dhe Banesave 2020

Misioni i parë në kuadër të projektit “Mbështetje për Censin e Popullsisë dhe Banesave 2020” kontraktuar nga Delegacioni Evropian në Shqipëri u zhvilluan në ambientet e INSTAT nga data 4 deri më 13 Shkurt 2019. Qëllimi i këtij misioni është të vlerësojë dhe monitorojë punën përgatitore për Censin, si dhe aktivitetet në terren (pilotin, terrenin dhe PES) për të siguruar mbarëvajtjen e projektit. Ekspertët janë të kontraktuar për 120 ditë pune gjatë një periudhë kohore 2-vjeçare.

Mision ad-hoc në kuadër të IPA 2015 mbi përgatitjen e planit të aktiviteteve për Pilotin e Censit

Në kuadër të përgatitjeve të planit të aktiviteteve për procesin Pilot të Censit, në ambientet e INSTAT u zhvilluan disa takime nga data 11-15 Mars 2019 me ekspertin ndërkombëtar i cili, në bashkëpunim me stafin e INSTAT, punoi ngushtë për përgatitjen e planit të aktiviteteve për Pilotin e Cens 2020.

Mision financiar nga INSEE në kuadër të Censit të Popullsisë dhe Banesave 2020

Më 27 – 29 Mars, në ambientet e INSTAT është organizuar misioni i ekspertit të financiar nga Instituti Kombëtar Francez i Statistikave dhe Studimeve Ekonomike (INSEE). Qëllimi i këtij misioni është të asistojë INSTAT në përgatitjen e analizës së riskut për aktivitetet e Censit të Popullsisë dhe Banesave 2020.

Takim teknik mbi Draft-Pyetëtorin e Censit 2020

INSTAT zhvilloi në muajin Janar tryezën konsultative për “Pyetëtorin e Censit të Popullsisë dhe Banesave 2020” me përfaqësuesit e institucioneve përgjegjëse për çështje që lidhen me karakteristikat e ndërtesave dhe banesave.

Gjatë kësaj tryeze u diskutuan pyetjet e pyetëtorit të ndërtesës dhe banesës, si dhe u mbledhën komente dhe sugjerime lidhur me to.



Finalizimi i draft-pyetësorit të Censit 2020

Gjatë periudhës Janar-Mars 2019, INSTAT ka punuar intensivisht për finalizimin e draft-pyetësorit të Censit 2020.

Në kuadër të përgatitjeve për Pilot-Censin, INSTAT ka përcaktuar kriteret e zonave në të cilat do të zhvillohet Piloti.

Për këtë qëllim, ka filluar puna për përgatitjen e materialeve ndihmëse (manualet) për kryerjen e punës në terren nga anketuesit, kontrollorët dhe supëvizorët.

Rekrutohet stafi i nevojshëm për Censin 2020



Instituti i Statistikave, në mbështetje të projektit të Censit 2020, ka shpallur njoftimin për pozicione të lira pune. Gjatë muajit Janar 2019, u publikuan në faqen zyrtare të INSTAT pozicionet për Koordinator Teknik, Koordinator Projekti, Koordinator Administrativ. Nisur nga rëndësia e këtyre pozicioneve dhe interesi i lartë i shprehur nga kandidatët, por edhe nga partnerët ndërkombëtarë, INSTAT vendosi shtyrjen e afatit të aplikimit me 2 (dy) javë të tjera, deri në datën 11.03.2019, me qëllim krijimin e hapësirave për aplikim të kandidatëve të tjerë të interesuar.

Ndërkohë, në faqen zyrtare të INSTAT janë shpallur fituesit për pozicionin “Specialist Prokurimi”, pozicionin “Specialist Programues” dhe pozicionin “Specialist Dizajner”. Gjatë muajit Shkurt, INSTAT ka shpallur procedurën e rekrutimit për pozicionin “Specialist GIS - për CENS-in e Popullsisë dhe Banesave 2020”, procedurë e cila vijon deri në shpalljen e fituesit.

Instituti i Statistikave do të zhvillojë vrojtimin e “Përditësimit të Hartave të Zonave të Censit, 2019” në mbështetje të Censit. Për këtë arsye, në muajin Shkurt në faqen zyrtare të INSTAT u shpallën vendet e lira për pozicionet “Operator GIS” dhe “Anketues Terreni”. Gjatë kësaj kohe janë zhvilluar procedurat e rekrutimit, (mbledhja e aplikimeve, shqyrtimi i tyre dhe intervistat) dhe janë përzgjedhur fituesit për pozicionin “Operator GIS”, lista e të cilëve është publikuar në faqen zyrtare të INSTAT.

Në muajin Mars, sipas kalendarit të publikuar në faqen zyrtare të INSTAT me të gjithë aplikantët e rretheve, janë zhvilluar intervistat për “Anketues Terreni” sipas shpërndarjes nëpër rrethe. Vijon procedura e rekrutimit për përzgjedhjen e anketuesve që përmbushin kriteret e kërkuara.


Procedurat e prokurimit për Censin e Popullsisë dhe Banesave 2020

Me qëllim zbatimin në mënyrë efektive të aktiviteteve të Censit 2020, si dhe duke marrë parasysh faktin që Censi do të mbështetet financiarisht nga donatorë të ndryshëm, INSTAT ka përgatitur manualin e procedurave të prokurimit i cili konsiston në rregullat që do të aplikohen, bazën ligjore, llojin e procedurës sipas rregullave të çdo donatori, si dhe planin e prokurimeve që i është përcjellë zyrtarisht CFCU si Autoriteti Kontraktues.

Gjatë tremujorit të parë 2019, bazuar në planin e prokurimeve, janë kryer procedurat si më poshtë:

- Procedura e vlerësimit për tenderin “Mbështetje për zbatimin e Censit të Popullsisë dhe Banesave 2020 në Shqipëri” me qëllim përzgjedhjen e kompanisë e cila do të sigurojë asistencë teknike për zbatimin e aktiviteteve të Censit 2020.
- Është zhvilluar procedura e prokurimit me objekt “Workstations and Computer desktop for GIS office specialists”, financuar nga projektin Sida Direct Funding. Aktualisht është lidhur kontrata dhe pajisjet janë dorëzuar në INSTAT.
- Në datë 25 Shkurt 2019, është lidhur kontrata e dhurimit ndërmjet INSTAT dhe IOM (International Organization for Migration), me objekt “Blerje Tabletash” financuar nga GIZ për anketën e migracionit, të cilët do të përdoren edhe për përditësimin e hartave në kuadër të aktiviteteve të Censit 2020.
- Ka nisur dhe është në proces procedura e prokurimit për marrjen me qira të dy automjeteve të cilat do të përdoren gjatë fazës përgatitore dhe në terren të Censit të Popullsisë dhe Banesave 2020.
- Ka nisur dhe është në proces procedura e prokurimit me objekt pajisje zyre për t’u përdorur për stafin i cili do të rekrutohet në kuadër të Censit 2020.

Nis procesi për përditësimin e hartave



Sektori i Gjeoinformacionit, në kuadër të përgatitjeve për realizimin e Censit 2020, pasi përfundoi punën për ngritjen e infrastrukturës së nevojshme për realizimin e anketës së përditësimit të hartave të zonave të censit dhe diskutimet, së bashku me hartimin e planit të punës për procesin pilot të Censit, nis aktivitetin e përditësimit të hartave më 1 prill 2019 që do të shtrohet në të gjithë vendin.

Anketa e përditësimit të hartave të zonave të censit është një nga aktivitetet e para dhe kryesore në fazën përpara Censit. Ajo do të shërbejë si një bazë paraprake për ushtrimin më të madh statistikor të INSTAT, Censin e vitit 2020.

Gjatë periudhës janar-mars 2019 janë realizuar një sërë detyrash si përgatitja e gjeodatabazës për punën në terren, finalizimi i pyetësorit të ndërtesave dhe hyrjeve, përgatitja e aplikacionit të posaçëm për përditësimin e hartave në terren, përgatitja e manualeve të punës (manuali i anketuesve të terrenit, manuali i operatorëve GIS, manuali i përdorimit të aplikacionit GIS), rekrutimi i operatorëve GIS, të cilët do të angazhohen me anketën e përditësimit të hartave në terren, rekrutimi i anketuesve GIS, të cilët do të angazhohen me anketën e përditësimit të hartave në terren, rekrutimi i specialistit GIS si staf ndihmës për sektorin e gjeoinformacionit, përgatitja dhe realizimi i trajnimit të operatorëve GIS dhe përgatitja dhe realizimi i trajnimit të anketuesve të terrenit.

INSTAT përgatit draft-aplikacionin për mbledhjen e të dhënave në terren

INSTAT, në funksion të përmbushjes së detyrave të procesit të Censit 2020 do të fillojë përgatitjen e draft-aplikacionit për mbledhjen e të dhënave në terren, duke u mbështetur në kriteret e përcaktuara të zonave në të cilat do të kryhet Piloti.

Shpallet hapja e konkursit për logon Cens 2020

Sektori i Publikimeve dhe Shpërndarjes së Informacionit ka shpallur hapjen e konkursit për zgjedhjet e logos së re të Censit të Popullsisë dhe Banesave 2020.

Konkursi zhvillohet në dy faza:

- Faza e parë zhvillohet nga data 11 mars deri në 3 prill, ku do të priten të gjitha propozimet e aplikantëve.
- Faza e dytë do të zhvillohet nga data 4 prill deri në 9 prill ku do të përzgjidhen tre fituesit e çmimit të parë, të dytë dhe të tretë.

Deri tani ka pasur një interes të lartë, jo vetëm nga studentë të Fakultetit të Arteve të Bukura dhe Fakultetit të Arkitekturës, por edhe nga nxënës të Liceut Artistik.

Të gjitha propozimet konkurruese do të vlerësohen nga një juri profesionistësh. Logo-ja fituese, e cila do të mbajë autorësinë e INSTAT, do të shpallet në datën 10 prill 2019 në faqen zyrtare të INSTAT.



Këshilli i Ministrave propozon Projektligjin e ri të Censit 2020



Në kuadër të përgatitjes së bazës ligjore për kryerjen e Censit, Këshilli i Ministrave i ka propozuar Kuvendit projektligjin e ri të Censit të Popullsisë dhe Banesave 2020.

Efekti kryesor i pritshëm nga ky projektligj është prodhimi i treguesve statistikorë të cilët mundësojnë një panoramë të përditësuar dhe reale mbi situatën demografiko-sociale në vend.

Projektligji synon arritjen e objektivave si vijon:

Së pari, prodhimin e statistikave të popullsisë dhe banesave duke mirëpërcaktuar me ligj:

- a) Rolin e INSTAT si institucioni përgjegjës për kryerjen e suksesshme të procesit;
- b) Rolin mbështetës që luajnë institucionet e ekzekutivit dhe ato të vetëqeverisjes vendore;
- c) Rolin e personelit të angazhuar në proceset e mbledhjes, përpunimit dhe publikimit të të dhënave;
- ç) Ruajtjen dhe administrimin e informacionit të mbledhur;
- d) Detyrimet e subjekteve për të dhënë informacionin e kërkuar nëpërmjet pyetësorëve të Censit;
- dh) Detyrimin e personave për të garantuar konfidencialitetin statistikor;
- e) Prodhimin e statistikave zyrtare të popullsisë e banesave në mënyrë profesionale shkencore dhe të besueshme.

Së dyti, kryerjen e Censit të Popullsisë e Banesave në përputhje me rekomandimet dhe standardet e reja ndërkombëtare duke:

- a) Përcaktuar terminologjitë statistikore në linjë me ato të përdorura nga Eurostat;
- b) Përbushur rekomandimet e institucioneve kompetente kombëtare dhe ndërkombëtare në lidhje me zhvillimin e censit të ardhshëm të popullsisë dhe banesave, veçanërisht atyre të dala nga Konferenca e Statisticienëve Evropianë (CES 2020) për Censet e Popullsisë dhe Banesave.

Së treti, harmonizimin e bazës ligjore me dokumentet e tjera që rregullojnë veprimtarinë statistikore në vend, duke marrë parasysh:


- a) Standardet e reja të përcaktuara nga Ligji nr. 17/2018 “Për statistikat zyrtare”;
- b) Strategjinë dhe planin për zhvillimin e Censit të Popullsisë dhe Banesave 2020 në Shqipëri;
- c) Strukturat mbështetëse të vetëqeverisjes vendore, sipas përcaktimeve të legjislacionit për ndarjen administrative dhe territoriale.

Projektligji është hartuar nga INSTAT në bashkëpunim me një grup ekspertësh ndërkombëtarë të siguruar me mbështetjen e qeverisë zvicerane dhe Zyrës Federale të Statistikave të Zvicrës, nëpërmjet projektit SALSTAT. Gjithashtu, projektakti ka marrë parasysh opinionet nga komunikimet e vazhdueshme, tryezat e rrumbullakëta dhe takimet me përfaqësuesit e institucioneve publike, grupeve të interesit, median, institucionet ndërkombëtare etj.

Përputhshmëria me *Acquis Communautaire* ka të bëjë me terminologjinë dhe përkufizimet statistikore, veçanërisht për sa i takon Rregullores 763/2008 e cila është direktiva bazë për censet në vendet anëtare.

Gjatë tremujorit të parë të këtij viti, INSTAT ka prezantuar projektligjin në Komisionin e përhershëm parlamentar për Integrimin Evropian. Projektakti pritet të diskutohet, gjithashtu, në komisionet e përhershme që mbulojnë çështjet ligjore, ekonomike dhe veprimtarinë prodhuese.

Ecuria e planit të aktiviteteve



INSTAT ka mbërritur në këtë fazë